

Misioni i strukturave komunitare

1. Të përfaqësojnë interesat e komunitetit dhe grupeve të interesit të lagjes apo fshatit dhe të përcjellin interesat dhe nevojat e komunitetit pranë bashkisë dhe aktorëve të tjerë, duke mundësuar ushtrimin e autoritetit sa më afër qytetarit.
2. Të mbështesin bashkinë për një qeverisje sa më të efektshme dhe efikase, si dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.
3. Të mbështesë zhvillimin vendor të udhëhequr nga komuniteti.
4. Të nxisin bashkinë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj nevojave të komuniteteve.
5. Të nxisin dhe mbështesin ndërtimin e kulturës dhe praktikave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis banorëve e bizneseve të lagjes apo fshatit dhe bashkisë.
6. Të promovojnë rrjetëzimin, të nxisin ndërveprimin dhe të inkurajojnë vullnetarizmin në lagje apo fshat, për të mobilizuar kontribute në funksion të rritjes së mirëqënies së komunitetit, arritjes së kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të lagjes apo fshatit.
7. Të promovojnë dhe mbështesin bashkëjetesën, harmoninë në komunitet dhe kohezionin shoqëror, për të përmirësuar cilësinë e jetës në lagje apo fshat.
8. Të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territori të lagjes apo fshatit.
9. Të zbusin polarizimin politik në komunitet.

Neni 1

Statusi i strukturave komunitare

1. Strukturat komunitare janë organizime vullnetare të komunitetit që ngrihen, zgjidhen dhe funksionojnë sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Strukturat komunitare janë të vetë-drejtuara, dhe të pavarura, përsa është e mundur.
3. Bashkia merr në konsideratë përgjigjen e kryesisë së fshatit apo këshillit komunitar për kërkesa dërguar atyre për këshilla, rekomandime apo reagime në lidhje me vendime apo projektet e bashkisë që i ndikojnë direkt fshatit apo lagjes.
4. Përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe aktivitetit të tyre strukturat komunitare:
 - a. Mund të mbështesin funksionet qeverisëse të Bashkisë në lagjen apo fshatin e tyre.¹
 - b. Zbatojnë urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë,² për sa kohë Bashkia vë në dispozicion të tyre burime, financiare, njerëzore, materiale dhe teknologjike.

² Ligji nr. 139/2015, neni 71/5.

c. Vendosin vetë se cilat çështje janë të rëndësishme për lagjen apo fshatin që duan të përcjellin pranë Bashkisë, si dhe çfarë kontributi dëshirojnë të japin për vendimmarrësit e Bashkisë në lidhje me këto çështje.

d. Marrin në shqyrtim dhe i përgjigjen me shkrim kërkesave të bashkisë për këshilla, rekomandime, komente apo reagime

d) Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e keshillave komunitare .